



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5106prot.

Ballsh më, 11.10. 2024

Njoftim për konsultim publik

Titulli dhe kodi i projektaktit:

Hartim i: Paketa Fiskale 2025, Projekt Buxheti i vitit 2025, Projekt Buxheti Afatmesëm 2025-2027, Shtimi i veprimtarisë së NSHP-së (Prodhim i inerteve).

Takimi publik:

Konsultimi publik do të organizohet sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

Të ftuar:

Të gjithë banorët e territorit të bashkisë Mallakastër, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, tatim paguesit e mëdhenj, OJF, Media, kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.

Pjesëmarrës nga bashkia:

Kryetar dhe këshilltarë të Këshillit bashkiak, Kryetari/Zv Kryetar i bashkisë, Sekretarja e Këshillit bashkiak, Koordinatorin për njoftim dhe konsultim me publikun, drejtues/punonjës nga Drejtoria e financës - Drejtoria juridike - Drejtoria e tatim-taksave, administratorët e Njësi Administrative, kryetarët e fshatrave.

Drejtuesi i takimit publik:

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Nexhmi Sulaj
Kryetari i Bashkisë Mallakastër Z. Qerim Ismailaj

Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrimi
1	Qëllimi i këshillimit publik	Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit Nr.146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publik”, i ndryshuar, të nenit 18, 54 shkronjat “dh”, “e”, “f” dhe “k” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në zbatim të rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, Këshilli Bashkiak Mallakastër njofton se do të organizojë seancë këshillimi dhe dëgjimi me publikun për diskutimin e projekt buxhetit 2025, paketën fiskale 2025 dhe PBA 2025-2027.
2	Përshkrimi i çështjes që trajton projektakti	Dëgjesë me publikun mbi prezantimin e: Paketës Fiskale për vitin 2025, Projekt Buxhetit të vitit 2025 dhe PBA-së 2025-2027. Prezantimi i prioriteteve dhe marrja e rekomandimeve nga qytetarët.
3	Projektakti dhe relacionin shoqërues	https://bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/PBA%202025-2027%20-%20Bashkia%20Mallakast%C3%ABr_compressed.pdf https://bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/PAKETA%20FISKALE%20viti%20%202025.pdf
4	Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	A mendoni se ndryshimet e parashikuara në këto draft projektvendime janë në përputhje me ato që ju konsideroni prioritete? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këto projektvendime? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këte draft projektvendim?
5	Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet projektakti	Qytetarë të Bashkisë dhe Njësive Administrative Mallakastër.
6	NjA, lagjet, fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime.	Bashkia Mallakastër, sipas kalendarit bashkëlidhur
7	Kalendari i takimeve dhe dëgjesave publike	Kalendari i datave, vendeve dhe orëve është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur këtij njoftimi. Për çdo lloj komunikimi jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet e-mailit: www.bashkiamallakster.gov.al

8	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 20.11.2024:</p> <p>2. Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në dëgjesat publike, apo mund t'i dërgoni me e-mail në adresën: www.bashkiamallakaster.gov.al, zahmetaj@bashkiamallakaster.gov.al</p> <p>ose nëpërmjet postës në adresën: L."18 Prilli, Ballsh, Mallakastër, tel:031323493, ballshi@bashkiamallakaster.gov.al www.bashkiamallakaster.gov.al</p>
9	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Këshilli bashkiak do të reflektojë sugjerimet dhe rekomandimet në projektvendimin që do të paraqes për miratim në mbledhjen e Këshillit bashkiak.

KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARËT E BASHKISË MALLAKASTËR

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Fratar	31.10.2024	09:00	Fratar
2	Ballsh, me tatim paguesit e mëdhenj	04.11.2024	10:00	Në sallën e mbledhjeve të bashkisë, kati i tretë
3	Ballsh	07.11.2024	10:00	Në ambjentet e Pallatit të Kulturës "Dino Kalenja"

KRYETARI KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

